



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborui Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 94/2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV), paraqitur kundër Mentor Baliaj në cilësinë e komisionarit nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Salih Hetemi në cilësinë e kryesuesit të Vendvotimit nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), për shkak të kërcënimit gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 26.01.2011, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV)

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë me datë 23.01.2011, nga subjekti politik LVV, me te cilën pretendohet se me datë 23.01.2011 rreth orës 09:55 në fshatin Tavnik QV1102B, shkolla fillore “Migjeni” Mitrovicë, është kërcënuar Egzon Jashari në cilësinë e vëzhguesit nga subjekt politik LVV nga Mentor Baliaj në cilësinë e komisionarit nga subjekti politik PDK. Më tej parashtruesi i ankesës potencon se pas këtij kërcënimi, vëzhguesi i LVV-së ka tentuar të shkruaj vërejtjet në librin e votimit por kryesuesi i Vendvotimit Salih Hetemi në cilësinë e kryesuesit të Vendvotimit nga subjekti politik LDD, nuk e ka lejuar por i ka ofruar disa fletë në gjuhen serbe për ti shkruar vërejtjet.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- **ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e potencuara në ankesë janë të pabazuara për shkak se nuk janë ofruar dëshmi për të besuar se ka ndodhur shkelja e tillë. Këtë e bënë edhe më të besueshëm raporti i policisë i datës 23.01.2011, në të cilin theksohet se pas marrjes së deklaratave nga personat e involvuar në këtë çështje është vërtetuar se nuk ka pasur ndonjë incident. Andaj PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 94/2011 më datën 26.01.2011

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

